

## Thuaj Idenë Tënde – Pjesëmarrje direkte e punonjësve të Grupit

Speak up your idea-Direct participation of Balfin Group Employees

AlbChrome prezanton ndërtimin e Furrave të Ferrokromit

AlbChrome presents the construction of ferrochrome furnaces

Një histori pas 'Bli në Carrefour dhe fito'

A story behind 'Buy at Carrefour and win'

Rimodelimi i Market 5

Reshuffling of Market 5

Neptun fitues i medaljes së cilësisë "Best Buy"

Neptun Albania has been awarded the winner of the quality medal "Best Buy"

"Rolling Hills Luxury Residences"

Projektet Turistike

Touristic Projects

Albanian Skills në TEG

Albanian Skills in TEG

Festa 1 Qershorit

1st of June celebration

Gigandi i shitjeve me pakicë YUSK vjen së shpejti në TEG dhe QTU

The retail giant YUSK comes in QTU and TEG

Uljët vazhdojnë në TEG dhe QTU

Sales continue in TEG & QTU

Aktivitetet dhe ulje masive

Activities and massive sale

Fashion Group vijon me uljet gjatë gjithë sezonit veror

Fashion Group came with sales of 40% in the middle season

Grupi Balfin demonstron suksesin dhe përcakton sfidat për të ardhmen në Staff Retreat 22-24 Qershor

Balfin Group shows success and determines its future challenges at Staff Retreat on 22-24 June

Trajnime në Grupin Balfin

Trainings in Balfin Group

Trajnimet e Neptun Albania me LG, SEB Group, Bosch dhe Samsung

Trainings of Neptun Albania with LG, SEB Group, Bosch and Samsung

Punonjësit e rinj prezantohen me Neptun dhe Grupin Balfin

New employees are introduced to Neptun and Balfin Group

Punonjësit e Carrefour trajnohen në "HACCP"

Carrefour Employees train in "HACCP"

haPPy - programi feston 1-vjetorin e tij

haPPy - Programme celebrates its 1st Birthday

Ngritja në detyrë

Promotion

Trajnime dhe zhvillimet

Trainings and developments

Tregu organik

Organic Bazar

Eventi për Fëmijë

Fair for Children and Family

Dita e botërore e ngjyrosjes për fëmijët

World Kids Coloring Day

Koncert i Grupit One Republic

One Republic concert

Klubi i Fëmijëve të Qytetit

City Kids Club

Promovime, Punonjës të Rinj

Promotions, New Employees

Punonjës të Rinj

New Employees

Praktika Mësimore në Grupin BALFIN

Internship at BALFIN

YAMATO, shija e vërtetë Japoneze në zemër të Tiranës

YAMATO, true Japanese taste in the heart of Tirana

Tendencat Verë 2015

Summer 2015 trends

Përfundon me sukses konkursi kombëtar "Sipërmarrësit e së Nesërme"

Successful completion of the national competition "Future Entrepreneurs" & "Future Jurists"

Leksion i Hapur mbi Komunikimin Online

Open Lecture on Online Communication

Studentët dhe stafi i TBU dhurojnë gjak për fëmijët Talasemikë

Students and TBU staff donate blood for Talasemic Children

9 mënyra për përmirësimin e gjendjes në punë

9 ways to instantly improve your mood at work

Librat e rinj në Bookstore

New books at Bookstore

Premierat e filmave me të fundit

Movies that will be displayed

Përfshirje

Involvement

Raportime nga punonjësit

Employee Reports

## Thuaj Idenë Tënde – Propozime konkrete nga punonjësit e grupit

Speak up your idea - Direct participation of Balfin Group Employees

Thuaj idenë tënde projekti i nisur nga Grupi Balfin fillimisht në Dhjetor të vitit 2014 për të mbledhur dhe stimuluar propozime për përmirësimin e punës nga ana e punonjësve tashmë ka marrë një formë dhe trajtë të re e cila ka filluar të japë rezultate konkrete në gjenerimin e ideve dhe propozimeve nga ana e punonjësve të Grupit. Kjo infrastrukturë tashmë vjen tek gjithsecili prej nesh në një format më të prekshëm dhe rezultativ. Nëpërmjet këtij mekanizmi po kërkohet nga punonjësit të japin idetë e tyre dhe ti dërgojnë ato në adresën [ideame@balfin.al](mailto:ideame@balfin.al) brenda një afati kohor të përcaktuar.

Gjithashtu, risi në këtë proces është edhe krijimi i komitetit të inovacionit i cili është i ndryshëm për çdo fushatë dhe bën përzgjedhjen e ideve fituese.

Po kështu punonjësit me idetë më të mira të cilat kanë gjetur zbatim nga kompanitë e ndryshme janë shpërblyer me çmime dhe vlerësime speciale bazuar në produktet dhe shërbimet e secilës prej shoqërive që kanë qënë dhe do të jenë pjesë e kësaj nisme.

Kjo metodë e re e gjenerimit të ideve ka gjetur zbatim në 2 fushatat e para që janë organizuar deri tani nga Carrefour dhe FoodWay dhe fituesit e tyre kanë ofruar sugjerime shumë të vlefshme. Për herë të parë idetë u fokusuan tek kompania që mund të kishte më tepër nevojë për suportin e grupit. Si kompania më e re në grupin Balfin, Carrefour, u vendos në qendër të vëmendjes për të pritë sugjerime dhe ide për rikuperimin dhe përmirësimin sa më të shpejtë. Kështu lindi 'Një ide për Carrefour', ku përgjatë një jave u mbledhën ide të bukura nga ana e punonjësve, të cilat u shqyrtuan duke parë mundësitë reale për implementim. Mes ideve dhe sugjerimeve ajo që tërhoqi më shumë vëmendjen ishte propozimi i **Z. Nertil Myrtollari**. Në fakt Nertili nuk ishte ndalur në një ide, por tek disa të tilla, të cilat u pëlqyen dhe u gjykuan si alternativa reale për implementim. Kështu komisioni i vlerësimit gjykoj se Nertili do të ishte edhe përfuturi i dhuratës së dy kuponave 10.000 Lekësh. Idetë e Nertilit kanë filluar të zbatohen në Carrefour.



"Speak up your idea" a project which was started initially by Balfin Group in December 2014 to gather and stimulate proposals for work improvement by the employees, has been reshuffled in a way which should give concrete results in the generation of ideas and proposals from Group employees. This infrastructure now comes to each of us in one of the most tangible and result-driven form. Through this mechanism employees will be required to give their ideas and send them to [ideame@balfin.al](mailto:ideame@balfin.al) within a certain deadline.

Furthermore, a novelty in this process is the establishment of the Innovation committee which is different for each campaign and makes the selection of winning ideas.

Likewise, employees with the best ideas which have been applied by different companies are rewarded with special prizes based on products and services of companies that have been and shall be part of this initiative.

Nga ana tjetër, kompania e dytë e grupit për të cilën u gjeneruan shumë ide të mira ishte Foodway. Në përfundim të procesit të propozimeve dhe ideve të dërguara nga punonjësit, u përzgjedhën, **Z.Besmir Banushi**, Përgjegjës i Divizionit të Produkteve të Freskëta në Carrefour dhe **Znj. Flutura Tola**, Inxhinieri zyre në Departamentin Teknik në Mane TCI.

Disa prej sugjerimeve të tyre për FoodWay ishin: Shtimi i një serie menuje të përcaktuar për fëmijë; diversifikim të menisë duke shtuar oferta për familjen; vendosja e kutive të vogla votimi për shërbimin dhe cilësinë e ushqimit; promovim për Yamato; futja e vaktit të mëngjesit etj.

Në këtë kuadër, do të kërkojmë nga të gjithë punonjësit e Grupit Blafin që të vijojnë dhe të kontribuojnë më idetë dhe sugjerimet e tyre për të patur një mejdis sa më të mirë pune, për të patur sa më shumë lehtësira dhe avantazhe si dhe për të qënë gjithnjë një hap përpara me konkurrencën.

This new method of generation of ideas has found application in the first 2 campaigns organized until now from Carrefour and FoodWay and their winners have offered very valuable suggestions.

For the first time the ideas were focused on the youngest company of the group that needed its support.

As the newest company in Balfin Group, Carrefour, was once more at the center of attention to welcome ideas and suggestions for a faster recovery and improvement. That is how **'An Idea for Carrefour'** was born, where during one week interesting ideas were given by employees which were then reviewed in order to see their real possibilities for implementation. Among the ideas and suggestions the one which attracted attention was the proposal of **Nertil Myrtollari**. In fact Nertil did not only have just one idea, he had several which were liked and judged as real options for implementation. Thus the evaluation committee judged that Nertil would also be the beneficiary of the present of two slips of ALL 10.000. Nertil's ideas are already being

implemented in Carrefour.

On the other hand, the second company of the group to which were generated a lot of good ideas was **Foodway**. At the end of the proposal process, and the sent ideas from the employees, there were selected, **Mr. Besmir Banushi**, Head of Fresh Products in Carrefour; and **Mrs. Flutura Tola**, Office engineer in Technical Department in Mane TCI.

Here are some of their suggestions for Foodway: to increase the articles in the children's menu; to diversify the menu by adding offers to the family; to set small voting boxes to express their opinion about service and food quality; promoting more Yamato; to include the breakfast, etc.

In this context, we kindly ask all the employees of Balfin Group to continue to contribute with their ideas and suggestions to have a better working place, to have more facilities and advantages and always to be one step ahead with the competition.

## AlbChrome prezanton teknologjinë më të avancuar në ndërtimin e Furrave të Ferrokromit në Elbasan

AlbChrome presents the most advanced technology in the construction of ferrochrome furnaces in Elbasan



Kompania AlbChrome, nëpërmjet një plani investimesh prej 3 milion dollarësh ka arritur të kthejë Uzinën e Ferrokromit në Elbasan në uzinë me teknologji shumë të avancuar sot në këtë industri.

Procesi i shkrirjes së kromit dhe më pas kthimi i tij në Ferrokrom tashmë është një proces më efikas dhe më i sigurt. Uzina e Ferrokromit në Elbasan punon me dy furra shkrirje. Gjatë këtij viti AlbChrome ka investuar një vlerë prej tre milion dollarë duke i kthyer këto dy furra në Furra Shkrirje me dopio-nivel. Ashtu si në një numër shumë të vogël Uzinash të ngjashme në Europë e më gjerë, procesi i shkrirjes së metalit kryhet në një mënyrë të automatizuar që fillon nga dozimi i

lëndëve të para të cilat hidhen në furrë për shkrirje, e deri tek përpunimi dhe më tej dalja e ferrokromit. Praktikisht, kjo teknologji bën të mundur përzjerjen në mënyrë optimale të lëndëve të para, përpunimin dhe shkrirjen e tyre si dhe ndarjen në dalje të ferrokromit të pastër nga mbetjet e tjera metalike, gjithçka në mënyrë automatike. Kjo do të thotë që sot AlbChrome prodhon Ferrokrom me karbon të lartë të një cilësie 'premium', duke e renditur këtë produkt Shqiptar si nga të paktët prodhime vendase të një cilësie shumë të lartë dhe nga produktet më të dëshiruara në treg. Nga ana tjetër, ky investim bën të mundur rritjen dhe forcimin e sigurisë në punë duke i mbajtur punonjësit e Uzinës larg nga disa procese me rrezik të lartë dhe duke bërë të mundur prodhimin e Ferrokromit në kushte shumë të mira.



AlbChrome, with an investment plan of 3 million dollars has managed to transform Elbasan ferrochrome plant in the most advanced technology plant in this industry.

The chrome melting process and then its conversion in ferrochrome is now a more efficient and safe process. Elbasan ferrochrome plant works with two melting furnaces. AlbChrome has invested three million dollars this year turning such furnaces into double-level melting furnaces. Similar to a small number of same plants in Europe and further, the metal melting process is automated, starting with dosing raw material which is then entered into the furnace to be melt to ferrochrome processing and production.


Practically, such technology enables an optimal mixture of raw material, its processing and melting as well as separation of clean ferrochrome from other metal waste, everything automatically. This means that today AlbChrome produces ferrochrome with high carbon of "premium" quality, ranking such Albanian product as one of the few domestic products of a very high quality and one of the most wanted in the market. On the other side, such investment makes possible the growth and strengthening of security at work keeping the plant employees safe from some high risk processes and enabling ferrochrome production in very good conditions.

## CARREFOUR ALBANIA

### Një histori pas 'Bli në Carrefour dhe fito'

#### CARREFOUR ALBANIA

A story behind 'Buy at Carrefour and win'



Përgjatë muajve Maj dhe Qershor, Carrefour organizoi një llotari të dedikuar vetëm për stafin e grupit Balfin dhe disa prej kompanive partnere. Llotaria e shtrirë në gati 7 javë, dhe e ndarë në disa etapa bëri fitues 9 punonjës të grupit, të cilët fituan dhuratë të ndryshme çdo javë. Pjesëmarrja në llotari u zhvillua nëpërmjet kuponave të blerjeve në çdo pikë të rrjetit Carrefour. Për çdo blerje mbi 1000 Lekë të gjithë punonjësit e kompanive mund të bëheshin fitues të kuponave, TV HD apo edhe udhëtimit turistik të vendosur në dispozicion.

Nga më shumë se 1000 pjesëmarrës në llotaritë e 'Bli në Carrefour dhe fito!' ne kemi veçuar historinë mallëngjyese të fitueses tonë të parë, **Ornela Dervishi**. Ornela punon prej vitesh në Carrefour dhe pati mundësinë të udhëtonte në Stamboll së bashku me vajzën e saj. Por e veçanta qëndron tek fakti se për Ornelën dhe vajzën e saj nuk ishte hera e parë që udhëtonin drejt Stambollit, por, qëllimi këtë herë ishte tërësisht i ndryshëm nga më parë. Prej vitesh Ornela e kishte shoqëruar vajzën e saj në Turqi për të ndjekur vizitat dhe kurimet e nevojshme shëndetësore. Këtë herë ato e shijuan Stambollin nën një dritë tjetër në një fundjavë tërësisht turistike. **Është një kënaqësi e madhe që kjo llotari u bë shkak për t'i bërë një dhuratë të tillë Ornelës.**

During May and June, Carrefour organized a lottery dedicated only to the staff of Balfin Group and some partner companies. The Lottery was extended in 7 weeks and in several stages, it announced 9 winners, group employees who won several presents each week. Participation in the lottery was developed through payment slips at each Carrefour network point. For each purchase of ALL 1000 all company employees could become winners of the available slips, HD TV or even tourist travel.

Out of more than 1000 participants in "Buy at Carrefour and win!" Lottery, we have chosen the touching story of our first winner, **Ornela Dervishi**. Ornela has been working at Carrefour for a long period and had the possibility to travel to Istanbul together with her daughter. But what is special for Ornela and her daughter is the fact that although this was not the first time for them to travel to Istanbul, the purpose this time was completely different from before. For many years Ornela had accompanied her daughter in Turkey to attend the necessary medical visits and treatments. This time they enjoyed Istanbul in a weekend completely dedicated to tourism. **It is a great pleasure that such lottery became the cause to make such a present to Ornela.**

## Rimodelimi i Market 5

### Reshuffling of Market 5

Në vazhden e ndryshimeve rrënjësore që Carrefour po përjeton pas blerjes nga grupi Balfin, sigurisht që nuk mund të mungonin edhe rimodelimet e dyqaneve ekzistuese. Të konceptuara për të qenë sa më pranë klientit në pikat më strategjike të qytetit, marketet janë një pjesë shumë e rëndësishme e Carrefour. Me këtë qëllim, u realizua rimodelimi i një prej marketeve më të rëndësishme, ai në rrugën Abdyl Frashëri, pranë Librit Universitar. Rimodelimi konsistoi në disa riparime funksionale, në zgjerim dhe riorganizim të hapësirave dhe rimodelim. Për të inaguruar dhe për të festuar këtë ndryshim, u mendua një formë promovimi në terren në mënyrë që të rindërtohej një komunikim me i afërt me klientët. Një ofertë e veçantë u mendua që të shoqëronte këtë ditë ndryshe. Oferta e uljes 10% për çdo blerje në atë market në atë ditë të caktuar u njoftua në zonën e mbulimit të marketit paraprakisht dhe ditën e eventit tërhiqëm vëmendjen e kalimtarëve me promocion, muzikë e degustime.

Ky event i vogël rezultoi shumë i suksesshëm dhe njëkohësisht tregoi se Carrefour është i mirëpritur dhe se kontakti direkt me klientët është gjithmonë mënyra më e mirë për t'i treguar atyre që jemi ende këtu dhe që gjithçka ka ndryshuar.



Following the continuation of radical changes that Carrefour is experiencing after the purchase from Balfin Group, surely the reshuffling of existing shops could not miss. Designed to be as close to the client as possible, in the strategic points of the city, the markets are a very important part of Carrefour. With this purpose was reshuffled one of the most important markets, the one in Abdyl Frashëri Street, near Libri Universitar. The reshuffling consisted in some functional repairs, extension and reorganization of space. To inaugurate and celebrate this change, a form of field promotion was thought in order to reconstruct a closer communication with the clients. A special offer was thought to accompany this special day. The discount of 10% for each purchase in that market on that specific day was announced in the area the market covers beforehand and on the event day we could attract the attention of passersby with promotion, music and tasting. Such small event resulted very successful and at the same time showed that Carrefour is welcomed and that direct contact with the client is always the best way to show them that we are here and that everything has changed.



## Neptun fitues i medaljes së cilësisë “Best Buy” “Rrjeti më i mirë i shitjes me pakicë për pajisjet e teknologjisë”

Neptun Albania has been awarded the winner of the quality medal “Best Buy” “  
The best retail network for technology equipments”

Neptun shpallet fitues i Çmimit të Cilësisë “Best Buy” si ofrues i raportit më të mirë çmim-cilësi, për vitin 2015 për produktet e teknologjisë dhe ato elektroshtëpiake në Shqipëri.

Konsumatorët shqiptarë, bazuar në eksperiencën dhe opinionin e tyre, vlerësojnë Neptun si kompaninë No.1 që ofron vlerën më të madhe të përfituar për sasinë e shpenzuar dhe shërbimin e marrë.

Neptun tashmë mban medaljen prestigjioze “Best Buy” duke ju bashkuar grupit të kompanive lider të certifikuara për cilësi në shërbim.

“Best Buy” është çmim i fituar pas një studimi tregu ku variable të matur janë eksperiencën konsumatore, kënaqësia në blerje dhe perceptimi se cila kompani ofron vlerën më të mirë për sasinë e parave të shpenzuara. Çmimet dhe Çertifikatat e Cilësisë “Best Buy” emetohen nga organizata Zvicerane ndërkombëtare, e pavarur, e certifikimit ICERTIAS- International Certification Association.

Neptun has been given Quality Award “Best Buy” offering the best price-quality ratio for the year 2015 for technological and home products in Albania.

Albanian consumers based on their experience and opinion value Neptun as the No.1 Company which offers the highest value gained for the amount spent and the service received.

Neptun is now a holder of the prestigious medal “Best Buy” joining other leader companies certified in quality and services. “Best Buy” is an award after a market research where the variables measured are the consumer’s experience, purchasing value and the perception of which company offers the best value for the amount of money spent.

The awards and Certificates of “Best Buy” are emitted from the International Swiss Independent Certification organization ICERTIAS- International Certification Association.

**NEPTUN**

Neptun fitues i medaljes së cilësisë “Best Buy”  
“Rrjeti më i mirë i shitjes me pakicë për pajisjet e teknologjisë”



# MANE TCI

## Rolling Hills Luxury Residences


"Rolling Hills Luxury Residences" një nga të vetmet zona rezidenciale në Tiranë, e pajisur me të gjithë kushtet për një jetesë të një standarti luksoz, e gjendur shumë pak kilometra larg qytetit tashmë ofron shërbimet për mirëmbajtjen dhe administrimin për banorët e saj. Ambjentet e përbashkëta, kanë filluar të menaxhohen në mënyrë të rregullt dhe banorët e kësaj zone kanë mundësinë të shijojnë edhe bukuritë e natyrës dhe ajrin e pastër në parkun rekreativ plotësisht funksional.

"Rolling Hills Luxury Residences" one of the only residential areas in Tirana, offering all the conditions for luxury standards of living, placed a few kilometers away from the city, now offers services for maintenance and administration for its residents. The common areas are managed in a regular and professional manner and the residents of this area have the opportunity to enjoy the nature's beauties and the fresh air in the recreational park which is totally functional.



## Projektet Turistike

### Touristic Projects



**"Green Coast Resort"** projekti i parë turistik në zonën e Palasës me një design dhe arkitekturë krejtësisht të veçantë, i konceptuar si një kompleks rezidencial me vila, apartamente dhe hotel ka filluar procesin e shitjes. Buzë rrugës së Palasës ka nisur promovicioni për shpërndarjen e fletëpalosjeve materialeve të tjera promovionale, i cili do të pasurohet edhe më shumë në ditët në vijim.

**"New Born Resort"**, një tjetër investim i ri i Grupit Balfin në fushën e turizmit elitare ka filluar punimet për ndëtimin e një kompleksi unik. Ky kompleks ndodhet në zonën e Hamallaj, në një nga zonat më të preferuara të pushimeve për shqiptarët por dhe të huajt, në Gjirin e Lalzit. Kompleksi do të ofrojë vila dhe apartamente moderne, në një komunitet të strukturuar. Për më shumë informacion rreth projektit, kontaktoni me Departamentin e Shitjes pranë Mane TCI.

**"Green Coast Resort"**, the first touristic project in Palasa area with a very special design and architecture, conceived as a residential complex with villas, apartments and hotel has begun the sale process. Nearby Palasa road the promotion has started, distributing promotional materials which will be enriched and increased further in the coming days.

**"New Born Resort"**, another new investment of Balfin Group in the field of elite tourism has started its work for the construction of a unique complex. This complex is placed in Hamallaj area, one of the most preferred areas of Albanians and foreigners holiday goes, in Gjiri i Lalzit. The complex will offer modern villas and apartments, in a structured community. For more information about this project, contact with the Sales Department in Mane TCI.

Të gjithë punonjësit janë të lutur që të ofrojnë kontributin e tyre në promovimin sa më gjerësisht të këtyre komplekseve si në rrjetet e tyre sociale ashtu dhe në komunikimin e përditshëm me njerëzit. Gjithashtu, për secilin punonjës që sjell një klient do të ofrohet komision. Në lidhje me komisionin, stafi i shitjeve dhe marketingut të Mane TCI mund të ofrojë një informacion më të detajuar.

All the employees are pleased to offer their contribution to a wide promotion of these complexes, in their social networks and in daily communications with people. Also, for each of the employees will be offered a commission. Regarding the commission, the sales and marketing staff in Mane TCI will offer a more detailed information.



## AKTIVITETI I TEG DHE QTU

### Albanian Skills në TEG

Albanian Skills in TEG



Më datë 16 maj, u zhvillua në TEG konkursi “Albanian Skills”, një projekt i cili kishte si qëllim promovimin e aftësive të të rinjve Shqiptarë, një mënyrë shumë e mirë për të përmirësuar arsimin dhe aftësimin profesional në shoqërinë tonë. Projekti i cili u mbështet nga vullnetarë ndërkombëtarë, në partneritet me një organizatë vendase pritet të jetë një traditë në shumë vende, përfshirë dhe Shqipërinë.

TEG mirëpriti organizatorët duke u promovuar si destinacioni që mbështet realizimin e ideve të biznesit, projektet, ngjarjet etj. Mbi 300 pjesëmarrës morën pjesë në këtë eveniment.

On the 16th of May TEG hosted the development of the “Albanian Skills” competition, a project whose aim was the promotion of Albanian youth skills: a very good method to improve vocational education and training in our society. The project which was supported by international volunteers, in partnership with domestic organizations, is expected to be a tradition in many countries, including Albania.

TEG welcomed the organizers by being promoted as the destination which supports the realization of business ideas, projects, events, etc. Over 300 participants took place in such event.

## Festa 1 Qershorit

1<sup>st</sup> of June celebration

TEG organizoi festa dhe aktivitete të shumta gjatë ditës së fëmijëve më 1 Qershor. Vizitorët kaluan Festën e Fëmijëve mes lojrave, argëtimit, dhuratave dhe uljeve. Atmosfera ishte e jashtëzakonshme dhe si çdo herë TEG u konfirmua si destinacioni ideal për të kaluar ditët e festave mes aktiviteteve të larmishme.

TEG organized a lot of celebrations and activities in Children's Day on 1st of June. Visitors passed the Children's Holiday through games, entertainment, presents and sales. The atmosphere was incredible and as every time TEG was confirmed as the ideal destination to pass the holidays through varied activities.

The retail giant YUSK “everything for your house” comes in QTU and TEG.



## Gjigandi i shitjeve me pakicë JYSK “çdo gjë për shtëpinë” vjen së shpejti në TEG dhe QTU

The retail giant JYSK “everything for your house” comes in QTU and TEG

Tashmë është firmosur marrëveshja me Grupin Jysk të cilët shumë shpejt do të jenë prezent në qendrat tona tregtare TEG dhe QTU. Me anë të kësaj marrëveshje qerramarrje, duke qenë prezent në qendrat tona tregtare, Grupi Jysk jo vetëm do të plotësojë portofolin e qendrave tregtare të Grupit Balfin, por do të jetë një avantazh unik në tregun tonë për vetë tipologjinë dhe gamën e produkteve që ofron.

Jysk përbën një nga rrjetet botërore më të mëdha të shitjeve me pakicë që shet “çdo gjë për shtëpinë”. Këto produkte vijnë për konsumatorët me ndërthurjen e cilësisë perfekte nordike dhe çmimeve të leverdisshme duke bërë që secili prej nesh të mund të gjejë gjithçka për shtëpinë nën një çati.

An agreement has been signed with Jysk Group which soon will see this giant of retail be present in our commercial centers TEG and QTU. Through this renting agreement, being present in our commercial centers, Jysk Group will not only fill up the Balfin's Group commercial centers portfolio, but will be a unique advantage in our market for its typology and the range of products that offers.

Jysk is one of the greatest networks of retail which sells “everything for home”. These products come to the Albanian consumers as a combination of the perfect Nordic quality with the most convenient prices, enabling for everyone to find everything for the home under one roof.

## Uljet vazhdojnë në TEG dhe QTU

### Sales continue in TEG & QTU

Gjatë muajve në vijim TEG dhe QTU do të vijojnë me uljet në të gjitha dyqanet e tyre. Këto ulje priten të përshkallëzohen dhe më tej në raport dhe me rritjen e temperaturave të stinës. Na vizitoni në qendrat tona dhe ne do t'ju shërbejmë me kënaqësi.

During next months TEG and QTU will continue with sales in all their stores. These sales are expected to have further escalation in connection with the raising of the season temperatures. Visit us in our commercial centers and we will serve you with pleasure.

## FASHION GROUP

### Aktivitete dhe ulje masive

#### Activities and massive sale



Si në çdo periudhë të vitit edhe përgjatë këtyre dy muajve Fashion Group ka qenë mjaft aktiv duke organizuar festa fëmijësh për ditën e tyre. Festa e 1 Qershorit ka filluar më herët dhe ka vazhduar pothuaj deri në fund të muajit Qershor me evente dhe oferta nga Prenatal dhe Okaidi. Gjatë këtyre ditëve u organizuan edhe konkurse me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe për fituesit Prenatal kishte përgatitur surpriza duke u ofruar fëmijëve një set fotografik profesional dhe organizimin e festës së ditëlindjes.

As in every season of the year, during these 2 months Fashion Group has been active organizing children celebrations for their day. The 1-st of June Holiday has started sooner and has continued almost until the end of June with events and offers from Prenatal and Okaidi. During these days were organized competitions with children participation and Prenatal had prepared surprises to the winners offering a Professional Photos Set and the organization of their Birthday Party.

## Fashion Group vijon me uljet gjatë gjithë sezonit veror

### Fashion Group came with an enjoyable level of sales of 40% in the middle season

Në Qershor grupi organizoi Fashion Shopping Day për të gjitha brandet e saj si në QTU ashtu dhe në TEG. Ky event i konsideruar si një mundësi e leverdisshme blerjesh përpara uljeve sezonale konfirmoi edhe këtë vit interesin dhe pjesëmarrjen e madhe të blerësve.

Uljet vazhdojnë në të gjitha brandet dhe dyqanet e fashion group si në TEG ashtu dhe në QTU me çmimet më të mira me ulje deri në -50%. Këto ulje priten që të bëhen më të mëdha ndërsa vera bëhet dhe më e nxehtë.

Fashion Group aktualisht po përfundon kryerjen e negociatave me të gjithë furnitorët dhe pritet që këtë vit Fashion Group të jetë i suksesshëm dhe të vijojë të ofrojë mundësi dhe argëtim pa fund për konsumatorët e tij.

In June, the group organized the Fashion Shopping Day for all its brands in QTU and TEG. This event considered as a convenient buying possibility prior the season sales, this year again confirmed a great interest and participation of buyers.

Sales continue in all brands and stores of Fashion Group in TEG and QTU with the best prices and sales till -50%. These sales are expected to increase while the summer becomes hotter.

Actually, Fashion Group is finishing the negotiations with all suppliers and is expected that this year Fashion Group will perform better and be more successful and will continue to offer endless opportunities and entertainment to its consumers.



# Grupi Balfin demonstroi suksesin dhe përcaktoi sfidat për të ardhmen në Staff Retreat 22-24 Qershor

Balfin Group shows success and determines its future challenges at Staff Retreat on 22-24 June

Nga data 22-24 qershor Balfin Group organizoi Staff Retreat. Në këtë event 2 ditor të organizuar në Bodrum të Turqisë, morën pjesë drejtuesit më të lartë të Grupit, të shoqërive si dhe drejtues departamentesh.

Edlira Muka, Drejtore Ekzekutive e Grupit i uroi mirëseardhjen të pranishmëve duke përcaktuar njëkohësisht edhe qëllimin e zhvillimit të këtij aktiviteti: për të ndarë sfidat e së nesërme dhe për të përcaktuar fokusin e punës për vitin 2015.

Gjatë dy ditëve u zhvilluan aktivitete të shumta si ushtrime, diskutime, propozime, prezantime, punë në grup etj. Thelbi i të gjithë këtyre aktiviteteve ishte forcimi i frymës së grupit, bashkëpunimit, dhe punës në skuadër.

Në fund Presidenti i Grupit Z.Samir Mane vuri theksin tek fuqia dhe forca e Grupit Balfin, si dhe shpalosi strategjinë dhe planet e grupit për zgjerimin dhe fuqizimin e mëtejshëm.



On June 22-24 Balfin Group organized Staff Retreat. Senior managers of the Group, of the companies, and department heads took part in this 2 day event organized in Bodrum, Turkey.

Edlira Muka, Executive Director, welcomed the participants and at the same time stated the purpose of holding such activity: share future challenges and identify 2015 work focus.

During these two days several activities were developed, such as exercises, discussions, proposals, presentations, group work, etc. The aim of such activities was to strengthen the spirit of group work, collaboration and teamwork.

In the end, the President of the Group, Mr. Samir Mane stressed the force and power of Balfin Group and presented the group strategy and plans for further extension and strengthening.

## TRAJNIME DHE NGRITJE KAPACITETESH Trajnime në Grupin Balfin

Trainings in Balfin Group



Gjatë muajve Maj-Qershor, Grupi Balfin ka qenë majft aktiv në zhvillimin e trajnimeve që ndihmojnë ngritjen profesionale, forcimin e kapaciteteve të punonjësve.

Në këtë kuadër, më datat 29-30 Qershor u zhvillua trajnimi "I Lead". Zhvillimi i aftësive të leadershipit në të gjitha nivelet e kompanisë është sot sfida e të gjitha bizneseve të mëdha në botë. Pjesëmarrësit në këtë trajnim morën njohuri mbi mënyrën se si ata udhëheqin të tjerët dhe se si mund ta përmirësojnë atë duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kompanisë. Pjesëmarrësit u aktivizuan në zgjidhje problemesh, reflektime për përmirësimin e menaxhimit në kompanitë përkatëse nëpërmjet vënies në zbatim të praktikave të leadership-it, etj.

Në të njëjtën kohë edhe shoqëritë e grupit kanë vijuar me organizimin e trajnimeve specifike në fushat përkatëse që ata mbulojnë.

During May- June, Balfin Group has been active undertaking trainings to help the professional development, increase the capacity of the employees.

In this context, on 29-th-30-th of June took place "I Lead" training. Leadership skills development in all company levels is now the challenge of all big businesses in the world. The training objective aimed for the participants to understand the method how to lead the others and how to improve it by positively influencing the company development. Participants were active in problem solving, reflections in improving the management in relevant companies through the implementation of leadership practices, etc.

At the same time, even in Group's Companies has continued with some specific training in relevant fields that they cover.



## Trajnimet e Neptun Albania me LG, SEB Group, Bosch dhe Samsung

Trainings of Neptun Albania with LG, SEB Group, Bosch and Samsung



Kështu, gjatë muajve Maj-Qershor Neptun zhvilloi trajnime nga LG, SEB Group, Bosch dhe Samsung. Të pranishëm në këtë trajnim ishin stafi i shitjeve nga të gjitha dyqanet Neptun në Shqipëri. Në fund të trajnimeve u organizuan teste ku për pjesëmarrësit më të mirë u shpërndanë dhurata. Për të gjithë stafin pjesëmarrës në këto trajnime u shpërndanë dhurata simbolike.

Trainings were developed during May-June from LG, SEB Group, Bosch and Samsung partners of Neptun Albania. Present in this training was the sales staff from all Neptun shops in Albania. At the end of the training tests were organized and for the best participants presents were delivered. All the participating staff in this training received symbolic presents.

## Punonjësit e rinj prezantohen me Neptun dhe Grupin Balfin

New employees are introduced to Neptun and Balfin Group

Në datat 8-12 Qershor 2015 në sallën e trajnimeve në Neptun QTU u zhvillua trajnimi 5 ditor për të gjithë punonjësit e rinj në kompaninë Neptun. Ky trajnim kishte në qendër të tij njohjen e stafit me historikun e Grupit Balfin, kompanisë Neptun si dhe procedurat dhe sistemet e kompanisë.

On June 8-12th, 2015, Neptun QTU training room hosted the 5 day training for all new employees of Neptun Company. This training was focused on introducing the staff with the history of Balfin Group, Neptun Company as well as with the company procedures and systems.

## Punonjësit e Carrefour trajnohen në ``HACCP``

Carrefour Employees train in ``HACCP``

Për të gjithë punonjësit e Departamentit të Produkteve të Freskëta gjatë muajit qershor në Carrefour u zhvillua trajnimi i HACCP. Në këtë trajnim u diskutua se si Carrefour u garanton dhe do të vazhdojë t'i garantojë klientëve siguri ushqimore duke u bazuar te Objektivat dhe 7 Principet e HACCP (Analiza e Rreziqeve në Pikat Kritike të Kontrollit). Deri më tani janë zhvilluar 6 seanca trajnimi ku kanë përfituar 65 punonjës.

HACCP training was developed for all employees of the Fresh Products Department during June in Carrefour. In this training was discussed how Carrefour guarantees and continues to guarantee its customers food safety based on the Objectives and 7 Principles of HACCP (Hazard Analysis in Critical Control Points). Until now 6 training sessions have taken place with 65 employees to have benefited.



## NEPTUN MACEDONIA

### haPPy – programi feston 1-vjetorin e tij

haPPy – Programme celebrates its 1<sup>st</sup> Birthday

Programi i besnikërisë së Neptun Macedonia “haPPy” festoi 1-vjetorin e tij më 18 qershor. Në këtë mënyrë, fokusi kryesor i këtij muaji nuk ishte vetëm tek komunikimi i ditëlindjes, por edhe tek besnikëria e klientit. Ofruam për të gjithë klientët e rinj dhe ekzistues haPPy “Tarifën pa aplikime për kreditë haPPy”.

Krahas kësaj, zgjodhëm 10 klientët më të mirë të Neptunit dhe u bëmë atyre surprizë në pragun e shtëpisë me dhurata të vërteta. Kjo ide ishte për të krijuar efektin e shpërndarjes së informacionit.

Neptun Macedonia's loyalty programme “haPPy” celebrated its 1st birthday on June 18th. Thus, the main emphasis this month was not only on the Birthday communication but on the client's loyalty as well. We offered to all new and existing haPPy customers “No applications fee for the haPPy loan”.

In addition to that, we chose the Best 10 Neptun customers and we personally surprised them at their doors with real gifts. The idea behind it was to create a word-of mouth effect.



## Ngritja në detyrë

Promotion



Investimi në zhvillimin e burimeve njerëzore në Neptun Macedonia  
Departamenti tregtar i shoqërisë është shtuar me një anëtar të ri, znj. Elena Luskoska Tosevska që u bashkua me ekipin në pozicionin e Menaxheres së Produktit për Home A/V dhe aksesoret Home A/V.

Investing in development of Human resources in Neptun Macedonia  
The company's Commercial department grew with additional new member, it is Mrs. Elena Luskoska Tosevska who joined the team on the position of Product Manager for Home A/V and Home A/V accessories..

## Trajnimet dhe zhvillimet

Trainings and developments

Përmirësimi i njohurive të punonjësve në shoqëri është një proces i vazhdueshëm dhe një synim strategjik i departamentit tonë të burimeve njerëzore. Prandaj, në këtë periudhë organizuam një trajnim të jashtëm dhe një të brendshëm.

Trajnimi i parë u krye dhe u mbështet nga LG dhe iu dedikua shitësit të katit. Afro 70 persona morën pjesë. Ata me rezultatet më të mira në testin e njohurive morën dhurata.

Javën e fundit të qershorit, shoqëria organizoi një workshop të përshtatur posaçërisht për Menaxherët e Dyqanit për të përmirësuar dhe nxitur proceset aktuale të shitjeve. Si rezultat, u ndërtua një udhëzues shitjesh.

The improvement of the knowledge of the employees in the company is continuous process and strategic goal of our HR department. Therefore, in this period we had one external and one internal training. The first training was conducted and supported by LG and was dedicated to the Floor Salesman. Around 70 participants took place. The ones with highest scores on the test of knowledge received gifts.

Last week of June, the company organized specially tailored workshop for the Shop Managers to improve and promote the existing sales processes. As the result, a sales guide will be established.

# SKOPJE CITY MALL

## Tregu organik

### Organic Bazar

Tregu organik u fillua për të qenë burimi për të gjitha produktet e shëndetshme dhe vërtet organike që mund të gjenden në treg. Një herë në javë Tregu Organik do të jetë “qendër shëndetësore”, për të rritur ndërgjegjen për zakonet shëndetësore përmes mbështetjes së klientit dhe prodhuesve vendas

The Organic bazar was initiated to be the source for all the healthy and truly organic products that can be found on the market. Once a week - the Organic bazar will be the “health hub”, to raise the awareness for healthy habits among every customer and to support the local producers.



## Eventi për Fëmijë

### Fair for Children and Family



Për tre ditë në mesin e majit, Skopje City Mall ishte qendra më e madhe në vend për edukimin dhe zbavitjen e fëmijëve. Fëmijët u zbavitën me programin e argëtimit që u organizua për të plotësuar fantazitë e tyre më të mëdha. U organizuan shumë workshop-e kreative me Kids Club si dhe shumë modele arsimore për fëmijët dhe prindërit për sigurinë rrugore dhe rregullat e trafikut. Gjatë këtij eventi, të gjithë vizitorët kishin mundësinë të fitonin çmime tërheqëse që varionin nga TV, tablete, biçikleta dhe çmimi i madh: udhëtimi në Disneyland për të gjithë familjen.

For three days in mid-May, Skopje City Mall was the biggest hub in the country for children's education and entertainment. Children were amused with the fun program we tailored to meet their biggest fantasies. Lots of creative workshops with our Kids Club were organized too and plenty of educational modules for children and parents about road safety and traffic regulations. During the event, all visitors had the chance to win attractive prizes ranging from TV, tablets, bikes and the biggest prize: trip to Disneyland for the whole family.

## Dita e botërore e ngjyrosjes për fëmijët

### World Kids Coloring Day

Në ditën botërore të ngjyrosjes për fëmijët, në bashkëpunim me Staedtler, projekti synoi të festonte krijimtarinë e fëmijëve të rinj në mbarë botën si dhe dhënien e asistencës praktike për të gjithë fëmijët, pavarësisht ngjyrës së lëkurës, fesë apo etnisë.

On World Kids Coloring Day, the project aimed to celebrate the creativity of young children worldwide and also give practical assistance to all kids no matter their skin color, religion or ethnicity.

## Klubi i Fëmijëve të Qytetit

### City Kids Club

Klubi i Fëmijëve të Qytetit (City Kids Club) u fokusua tek workshopet kreative dhe seancat e animuara edukative në linjë me aktivitetet kryesore në qendrën tregtare. Një workshop i veçantë u organizua në bashkëpunim me Institutin Francez ku fëmijët bënë lojëra me formime figurash.

The City Kids Club was focused on creative workshops and animated educational sessions, in line with the main activities in the mall. Also a special workshop was organized in collaboration with French Institute, where the kids were making puzzles.



## Koncert i Grupit One Republic

